



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 21 dhe +22 21 21 22

Nr. Rregj.Them. 836(31010-00105-83-2016)
Dt. Rregj. 02.02.2016

Nr. Vendimi 430(353)
Dt. Vendimi 08.06.2016

V E N D I M
"NE EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Administrative e Shkallës së parë Shkodër e përbërë nga:

Valbona DURRAJ – gjyqtare

Asistuar nga sekretare seance Borana LITI, sot me datë 08.06.2016, ora 11.30 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen administrative me nr. Rregj. Them. 836(31010-00105-83-2016) datë 02.02.2016 që l përket palëve ndërgjyqëse:

PADITËSE: Florinda Gjonej, Person Fizik, Avokat, me nr. Liçense 3822 dhe NIPT K96803002R, me seli ne: Lagje "Qemal Stafa", Rr. "28 Nentori", Shkoder, cel: 0692947639.

TE PADITUR: 1.Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder,perfaqsuar nga znj. Siriana Bakushi.
2.Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane, perfaqsuar nga znj. Siriana Bakushi.

me pjesmarrje te: Avokatura e Shtetit Shkodër (në mungesë).

OBJEKTI: Shfuqizimi i Aktit Administrativ: Njoftim Vleresimi Tatimor me nr. 12164 te prot. te dt. 03\11\2015, i Drejtorise Rajonale te Tatimeve Shkoder, dhe i vendimit nr. 36487\2 te prot. te dt. 08\01\2016 te Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane, komunikuar ne dt. 13.01.2016.

BAZA LIGJORE: Neni 17\1\ a te ligjit 49\2012, "Mbi Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative, dhe Gjykimin e Mosmarreshjeve Administrative". Ligji 9220 i dt. 19\05\2008. VKM nr. 781 dt, 14\11\2007, neni 38\dh.

Gjykata në përfundim të hetimit gjyqësor, pasi administroi provat shkresore të paraqitura, dhe pasi dëgjoi palen paditese, e cila kërkoi përfundimisht pranimin e kerkese

padisë sipas objektit të saj, përfaqesuesen e palëve të paditura që kërkoi rrezimin e kërkesë padisë si të pambështetur në ligj dhe prova, në mungesë të Avokaturës së Shtetit Shkodër, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi:

VËREN se:

Paditesi Florinda Gjonaj, person fizik i është drejtuar Gjykatës Administrative Shkallë e Parë Shkodër me kërkesë padi kundër anës së paditur Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër dhe Drejtorisë së Apelit Tatimore, pranë D.Pergjithshme Tatimore Tiranë, me objekt: "shfuqizim i aktit administrative, njoftim vlerësim tatimor nr. 12164 prot date 03.11.2015 i DRT-Lezhe dhe i vendimit nr.36487/2 prot dt 08.01.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tirane,.

Florinda Gjonej është licensuar pranë organit tatimor, D.R.T Shkodër si subjekt e person fizik, me objekt aktiviteti "Avokati".

- Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër ka njoftuar subjektin me detyrime vlerësuar sipas njoftim-vlerësimit nr.12164 prot date 03.11.2015, denim me gjobe në vlerën 30 000 leke, pasi subjekti leshon kupon tatimor me mangësi elementesh ligjore gjatë ofrimit të shërbimit.

- Subjekti duke mos qenë dakort me këtë vlerësim i është drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Pergjithshme të Tatimeve Tirane me një kërkesë ankimore në lidhje me të.

Kjo Drejtori është përgjigjur me vendimin e saj, komunikuar me shkresën nr.36487/2 prot date 08.01.2016 subjektit dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, nëpërmjet të cilit vendos :

• *Lenien në fuqi të aktit administrativ, njoftim vlerësimit nr.12164 prot date 03.11.2015 të nxjerre nga D.R. T-ve dhe rrezimin e ankimit.*

Në bazë të Urdhrit të punës nr.503/10 prot date 07.09.2015 është ushtruar kontroll në ambientet e ushtrimit të aktivitetit të subjektit Florinda Gjonej, me numer Nipti K96803002R, në adresën Rr."13 Dhjetori", me objekt aktiviteti "avokati" dhe ka mbajtur Akt konstatimin me numer serie 0487030 date 09.09.2015.

Referuar përmbajtjes së këtij akti është konstatuar ndër të tjera, citohet:

"Në zbatim të Urdhrit të punës nr.503/10 prot date 07.09.2015 nga DRTSH

Nga kontrolli i ushtruar në subjekt rezultoi :

Subjekti ishte i rregjistruar në Q.K.R me numer Nipti K96803002R.

*Subjekti ishte i paisur me kase fiskale me nr.rregj. IV06005288 dhe **leshonte kupon tatimor me mangësi elementesh ligjore.***

Kishte të afishuar posterin "kliente ju lutem terhiqni kuponin tatimor".

Kishte të afishuar listen e shërbimeve

Në punë u gjend Florinda Gjonej me nr.Personal G15213188H.

Eshtë mbajtur Procesverbali i gjobës me numer serie 0191309 date 09.09.2015 sipas të cilit subjekti është sanksionuar me gjobe, pasi subjekti leshonte kupon tatimor jo të rregullt gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij në ofrimin e shërbimit, bazuar në nenin 122, pika 1, germa (c) të Ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore në RSH-se" i ndryshuar. Ligji nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore në RSH-se" i ndryshuar, neni 122 pika 1 germa (c) ka përcaktuar : 1. "Tatimpaguesi, person juridik ose fizik tregtar denohet në rast se :

c) leshon një kupon tatimor/deftese tatimor e/bilete me vlerë të parashtypur, që nuk përmban elementet e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, për kuponin

tatimor/ deftesen tatimore/ bileten me vlere te parashtypur, me gjcbe, ne masen 30 000 (tridhjete mijej leke.

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder ka njoftuar subjektin me detyrime vleresuar sipas njoftim-vleresimit nr.12164 prot date 03.11.2015, denim me gjobe ne vleren 30 000 leke,

Drejtori e Apelitit Tatimor nr. 36487/2 prot date 08.01.2016 ka vendos :

• *Lenien ne fuqi te aktit administrativ, njoftim vleresimit nr.12164 prot date 03.11.2015 te nxjerre nga D.R. T-ve dhe rrezimin e ankimit.*

Pretendimi i palës paditese :

Akti Administrativ e kundërshtoj si të paligjshëm për vetë arsye se kuponin tatimor i dt, 09.09.2015 është kupon i rregullt dhe se pasqyron një arketim që në kase ka kodin: GI, që do të thotë arketim pa lloj shërbimi por që paguhet tvsh prej 20% .

Inspektoret në dt. 09.09.2015, i kanë kërkuar të leshojnë një kupon me kase fiskale për të verifikuar gjendjen e kases në momentin e kontrollit (pra në atë ditë). është printuar një kupon në shumën prej 3000 leke pa asnjë lloj shërbimi, por thjesht Arketim.

Gjendja në punë e kases fiskale ka vazhduar deri në dt. 01.03.2016.

Duke qenë se sot për kategorinë e aktivitetit tim mosperdorimi i kases fiskale nuk përben shkelje aq me tepër pasaktësi në kuponin tatimor, për pasojë kërkoj pranimin e kërkesë padisë sipas objektit të saj, shfuqizimin e Aktit Administrativ, njoftim vleresimi Tatimor me nr. 12164 të prot. të dt. 03\11\2015, i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkoder, dhe të vendimit nr. 36487/2 të prot. të dt. 08\01\2016 të Drejtorisë së Apelitit Tatimor Tirane.

Ana e paditur prapsoi;

Në V.K.M-ve nr.781 date 14.11.2007, i ndryshuar në pikën 15, në lidhje me regjistrimin e qarkullimit, përcakton se: " *te gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakice, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në mjedise apo njeri të perhershme të hapura për publikun, instalojnë pajisje fiskale dhe leshojnë kupone tatimore për çdo transaksion*".

Në V.K.M-ve nr.781 date 14.11.2007 "Për karakteristikat Teknike e Funksionale të pajisjeve fiskale të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit për procedurë e dokumentacion për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen me autorizim të shoqërive të autorizuara për ofrimin e pajisjeve fiskale", i ndryshuar është përcaktuar se :

Kuponi tatimor, që i jepet një blerësi apo një klienti përmban të dhënat e mëposhtme :

a) emrin, adresën e tatimpaguesit dhe adresën e vendndodhjes së biznesit

b)NIPT-in

c)numrin e identifikimit të regjistruarit elektronik

e) logon fiskale

d)numrin rendor të kuponit, datën dhe kohën

dh) emrin, sasine, çmimin dhe vlerën e qarkullimit të regjistruar të mallrave dhe/ose të shërbimeve.... etj

Udhëzimi nr.16 date 03.05.2010 "Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale", i ndryshuar, në pikën 7. germa (e) në procedurën e

paisjeve me kase fiskale ka percaktuar detyrimin e tatimpaguesit per te dorezuar prane shoqerise se kaseve tizen me artikujt qe tregton apo sherben, ku citojme :

Tatimpaguesi,

e) Dorezon prane Shoqerise se autorizuar listen e te dhenave qe duhet te programohen ne kase (lista e mallrave/sherbimeve (artikujve), çmimet.... etj.

Ne kete rast nga tatimpaguesi nuk eshte permbushur detyrimi ligjor per leshimin e kuponit tatimor me te gjithë elementet. Nuk evidentohet sherbimi i kryer, lloji i tij.

Ne keto kushte gjoba e vene eshte ne perputhje me nenin 122 pika 1 germa (c) ka percaktuar :

1. "Tatimpaguesi, person juridik ose fizik tregtar denohet ne rast se :

c) leshon nje kupon tatimor/deftese tatimor e/bilete me vlere te parashtypur, qe nuk permban elementet e percaktuara ne kete ligj dhe ne aktet nenligjore, per kuponin tatimor/deftesen tatimore/biletën me vlere te parashtypur, me gjobe, ne masen 30 000.

Perfundimisht kerkojme pranimin e kerkese padise.

Gjykata veren se .

Detyrimi i tatimpaguesve per te instaluar dhe perdorur paisjen fiskale, percaktohet ne Ligjin nr.9920, date 19.5.2008 "Per Procedurat Tatimore ne R.Sh-se", i ndryshuar, neni 55 "Detyrimi per perdorimin e paisjeve fiskale", Udhezimin nr.24, date 02.09.2008 ne zbatim te tij, i ndryshuar, Kreu VI, pika 55 dhe Vendimin e KM nr.781, date 14.11.2007, i ndryshuar, Udhezimi nr.16 date 03.05.2010 "Per administrimin dhe dokumentimin e procedurave te pajisjeve fiskale", i ndryshuar....

Ne neni 55,

"Detyrimi per perdorimin e pajisjeve fiskale"

1. "Tatimpaguesit, qe kryejne qarkullimin e mallrave dhe te sherbimeve, per te cilat pagesat nuk kryhen nepermjet bankes, jane te detyruar te fusin dhe te perdorin sistemin fiskal, nepermjet perdorimit te pajisjeve fiskale, per regjistrimin e pagesave me para ne dore dhe per leshimin, ne menyre te detyrueshme, te kuponit tatimor.

4. Ministri i Financave, me udhezim, miraton proceduren dhe dokumentacionin per miratimin per perdorim te pajisjeve fiskale, elementet e kuponit tatimor, menyren e kontrollit dhe kontrollin e pajisjes fiskale, distancen e ruajtjes se kuponit tatimor dhe rregullat per mirembajtjen e tyre teknike e te sherbimit".

Ne Udhezimin nr.24 date 02.09.2008 "Per Procedurat Tatimore", i ndryshuar, "Detyrimi per perdorimin e Pajisjeve fiskale", pika 55 shprehet :

Personat e tatueshem, subjekte te tatimit mbi vleren e shtuar apo te tatimit mbi fitimin dhe personal e tatueshem, tatimpagues te "tatimit te thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel" jane te detyruar te pajisen, te perdorin dhe mirembajne pajisjet fiskale ne perputhje me dispozitat e Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.781, date 14.11.2007 'Per karakteristikat teknike e funksionale te pajisjeve fiskale, sistemit te integruar te kompjuterizuar per transferimet periodike, automatike te deklarimeve financiare, sistemit te komunikimit per proceduren e dokumentacionin per miratimin e tyre dhe per kriteret per pajisjen me autorizim te shoqerive te autorizuar per ofrimin e pajisjeve fiskale" dhe akteve te tjera nenligjore ne zbatim te tij.

Per pasoje ne kendveshtim te ketyre dispozitave ligjore dhe rrethanave te faktit rezulton se paditesi ka qene i paisur me kase fiskale sipas ligjit, dhe ne momentin qe grupi I kontrollit I ka kerkuar te leshohej nje kupon tatimore per te pare nese kjo kase fiskale eshte ne pune, veprimet e paditeses kane qene ne perputhje me vete ligjin (paraqitur ne cilesine e proves vete kuponi tatimore, i cili permban te gjitha elementet e nevojshme sipas parashikimeve te VKM nr.781 date 14.11.2007),

Neni 15.

Kuponi tatimor, permban te dhenat e meposhtme :

e) emrin, adresen e tatimpaguesit dhe adresen e vendndodhjes se biznesit

f) NIPT-in

g) numrin e identifikimit te rregjistruarit elektronik e) logon fiskale

h) numrin rendor te kuponit, daten dhe kohen

dh) **emrin, sasine, cmimin dhe vleren e qarkullimit te regjistruar te mallrave dhe/ose te sherbimeve.... etj**

pasi është komun tatimor qe gjenerohet nga vete kasa fiskale.

Ne vete përmbajtjen e kasave VKM nr 781 e te udhezimit nr.16 date 03.05.2010

" Per administrimin dhe dokumentimin e procedurave te pajisjeve fiskale", i ndryshuar, ne piken 7, germa (e) ne proceduren e paisjeve me kase fiskale ka percaktuar detyrimin e tatimpaguesit per te dorezuar prane shoqerise se kasave listen me artikujt qe tregton apo sherben, ku citohet :

Tatimpaguesi,

f) Dorezon prane Shoqerise se autorizuar listen e te dhenave qe duhet te programohen ne kase (lista e mallrave/sherbimeve (artikujve), çmimet.... etj.

Fakton se eshte pikerisht shoqeria koncensionare e kasave qe ka aksesin per te bere nderyrje ne kase, pasi tatimpaguesi eshte vetem perdorues I saje.

Po keshtu nga ana tjeter nenit 38 I VKM 781 pika dh, citohet

- nuk I detyron sherbimet e lira te paisen me kase fiskale,

qe do te thote, nisur nga vete aktiviteti qe paditesia ushtron, avokatë, profesion I lire, sherbimin ndaj klientit ne detyrim ligjore ajo e ofron me fature tatimore me TVSH dhe jo detyrimisht me kase fiskale, ndonese paditesi e ka dhe nje te tille.

Perfundimisht gjykata e gjen kerkimin e paditeses te bazuar ne prova dhe ligje dhe vendos pranimin e saj dhe, meqenese vlere e aktit është më e vogël se 20 fishi i pagës minimale në shkallë vendi, ky vendim është i formës së prerë, prandaj

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 40, 41, 42 dhe 45 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", nenit 126,306 dhe 310 të K.pr. Civile

VENDOSI

-Pranimin e kërkesë padisë.

-Shfuqizimin e Aktit Administrativ, Njoftim Vleresimi Tatimor me nr. 12164 prot. dt. 03\11\2015, i Drejtorise Rajonale te Tatimeve Shkoder, lënë në fuqi me vendimin nr. 36487\2 prot. dt. 08\01\2016 te Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane.

Ky vendim është i formë së prerë, përbën titull ekzekutiv dhe do të ekzekutohet menjëherë.


-Shpenzimet gjyqesore (në vlerën e taksës së padisë 3000 lekë), në ngarkim të anës së paditur.

Kundër vendimit nuk lejohet ankim.

Shkoder me date 08.06.2016

SEKRETARE SEANCE

Borana LITI



PULLE TARIFE
200
LEKE
R.SHQPERISE

GJYQTARE

Valbona DURRAJ

